




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-4822/21 datë:23.02.2021



Npi – 01/57 datë: 04.03.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 04.03.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 04.03.2021, (e enjte) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, z.Naim Zejna, z.Skender Hyseni, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, znj.Marigona Pajaziti, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamed Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Kryetari z.Naim Ismajli, Drejtorat, Zyrtarja Kryesore Financiare znj.Kimete Ukaj; Zyrtari për Informim, z.Lulzim Sahiti; Përfaqësuesi i OJQ-së “YAHР” z.Bekim Krasniqi, Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, Praktikantja, znj.Sevdie Selimi, Zyrtari i IT-së Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstatoj, Kuorumin prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2021,
2. Pyetje-Pergjigje,
3. Raport i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të komunës së Shtimes për vitin 2020,
4. Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020,
5. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit,
6. Propozim-Vendim për këmbim të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të Kuvendit Npi-01/272, të datës 24.11.2020,
7. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Raçak,
8. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petrovë,

9. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Shtime,
10. Propozim-Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm të pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale - Petroviç (Lagja e Pajtimit),
11. Propozim –Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm N.K-1397/16, ZK-Shtime,
12. Shqyrtimi i Kërkesave.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapidiskutimin për rendin e ditës.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje për të gjithë. Materialin e kemi marrë me kohë. Meqenëse kemi hy në vitin zgjedhor, dhe disa pika që kanë të bëjnë me dhënien e tokës komunale në shfrytëzim, mund të konsiderohen si projekt elektoral, për këtë arsy unë propozoj, që pikat e nga 6 deri në 11 të hiqen nga rendi i ditës.

z.Shekfi Dauti; Përshëndetje, edhe unë jam që pikat e propozuara të rendit të ditës nga numri 6 deri te numri 11 të hiqen tëresisht nga rendi i ditës, dhe të mos na vijnë më fare në Kuvend për shqyrtim, le të merret Gjykata me to. Kemi psh. rastin e pronës të Xhafer Hysaj, dhe rastin e pronave te Puset e Ujësjellësit që po sillen vërdallë, ndërkaq që shumë pronave që tanë po kërkojnë shpronësimin e tyre, ne ua kemi shtruar asfalltin. Kështu që unë për këtë arsy po kërkoj që pikat 6 deri në 11 të hiqen dhe mos të qiten më në Kuvend.

z.Isak Muslija; Përshëndetje, mendoj se ky është një problem shumë i madh, prandaj unë kam qenë që me kohë kurë të shqyrtohet buxheti me u nda edhe shuma e caktuar e mjeteve financiare për shpronësimin e këtyre pronave. Edhe unë jam që të hiqen pikat 6 deri 11 nga rendi i ditës.

z.Ruzhdhi Jashari; Përshëndetje, këto prona po na sjellin probleme. Sa i përket shpronësimeve, ato janë krejt lëmsh. Prandaj ne jemi që të hiqen nga rendi i ditës pikat e propozuara të rendit të ditës nga pika 6 deri në pikën 11.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, nga distanca. Pajtohem edhe unë me propozimet e parafolësve, që pikat 6 deri 11 të hiqen nga rendi i ditës.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Përshëndetje, po jap përgjigje pavarësisht konstatimit te juaj se jemi në vitin elektoral, unë mund të them se jemi mirë me Ligjin, sepse ende nuk jemi futë në 6 mujorin që e parasheh Ligji për mostrajtimin e pikave që kanë të bëjnë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, dhe sa i përket kësaj jemi okej. Aspekti i dytë që ka të bpj me faktin se a janë apo jo në përputhje me Ligjin, ne ua heqim këtë dilemë, se janë plotësisht në përputhje me Ligjin. E treta, pikat 6 deri 11 janë pika të ndryshme, njëra është për këmbim, dhe të tjerat për shpronësim. Ne kemi obligim me ju dhënë një përgjigje, sepse kjo pika që ka të bëj me këmbim, është e lidhur me investime si dhe me pëlqimin e banorëve të fshatit. Shënimet që ua kemi ofruar janë të sakta. Unë vetëm desha të sqaroj se arsyetimet e dhëna nga ana juaj nuk qëndrojnë. Nuk qëndron propozimi që më mirë të shkojnë në Gjykata. Asfalltimi ka ndodhur tash më, por trasa ka ekzistuar edhe më parë. Për dilemat e aspektit Ligjor e kemi Zyrtarin Ligjor.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, ideja që mos të merremi me pikat 6 deri 11 është e gabueshme. Unë mendoj se ne duhet të merremi me secilën nga këto pika veç e veç.

z.Fehmi Hysenaj; Vullneti i anëtarëve të Kuvendit është ky, e arsy ka plot e përplot. Po të ishte Planifikimi i mirë, ne nuk do të vinim në një situatë të tillë. Shumë gjëra që lidhen me këto prona, ka mundësi që kanë lidhje me procesin e kaluar zgjedhor. Vullneti ynë është që pikat 6 deri 11 të hiqen nga rendi i ditës.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 7 vota “Për” me 13 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e aprovoi rendin e ditës të propozuar nga Kryesuesja e Kuvendit, prej 12 pikave.**

- * Kuvendi i Komunës, me 13 vota “Për” me 7 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” aprovoi rendin e ditës, pa pikat 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 sipas kësaj renditje:
1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.01.2021,
 2. Pyetje-Pergjigje,
 3. Raport i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të kom. së Shtimes për vitin 2020,
 4. Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020,
 5. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në reportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit,
 6. Shqyrtimi i Kërkesave.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 28.01.2021

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi, Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.01.2021.

Pika 2

Pjetje-Përgjigje

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna: Te pyetja paraprake, sa i përket Druve të konfiskuara që gjenden në oborrin e shkollës së mesme profesionale, përgjigja nuk është prezantuar si e plotë, prandaj po kërkoj që kjo pyetje të plotësohet dhe të përsëritet si vijon: A janë shitë drutë, kujt ju kanë shitë (kush është blerësi), dhe sa ju kanë shitë? Pyetja e dytë për Kryetarin, Lidhur me pagat jubilare dhe shujtat e ushqimit nga aspekti finaciari po më intereson, kur do të paguhen dhe nga cili kod buxhetor?

z.Ruzhdhi Jashari: Pyetja konkrete është për Kryetarin, Qka po ndodhë te Guri i Shtrejtë, pse po lejohet që të shkatrrohet ajo pjesë e trashëgimisë natyrore dhe ajo pjesë turistike e gjelbrimi të komunës tonë, ku ka shqetësimë të mëdha të banorëve në atë zonë, edhe pse ne kemi kërkuar që të futet në planin përmbytjen e trashëgimisë natyrore? Pyetja e dytë prap për Kryetarin, e dimë që në vitin 2019 i kemi themeluar dy drejtori jashtligjshëm? Kërkoj në mbledhjen e radhës një raport për këtë. Te rruga “Ahmet Shtimja” që shkon kah lagja e fshatit Petrovë “Balavit” e që lidhet me rrugën kryesore për Petrovë, që faktikisht këtë rrugë po e përdorin disa kompani për transport të zhavorrit pyetja është, a ka dhënë mjete financiare ndonjë Kompani private nëse po cila kompani dhe sa? Dhe pjesa dytë e pytjes, a ka investuar Komuna në këtë rrugë dhe sa ka investuar?

z.Fehmi Hysenaj: Përgjigjet nuk po janë të plota, nganjëherë edhe ato që janë të plota po janë qesharake, ndërsa sot i kam dy pyetje: Pse në disa shkolla nuk po matet temperatura e nxënësve? Rrugët që e përmendi Ruzhdhiu “Ahmet Shtimja” ka mbetur shumë keq, thuja se e pa kalueshme, pse nuk është përfunduar?

z.Muhamed Ademaj: Përshëndetje, Pyetje për DSHP-në, në fshatin Petrovë janë disa puseta pa kapakë, pytja është, kushë i mbikqyrë në komunën e Shtimes pusetat e kanalizimit, kërkesa e banorëve është që çdo puset të ketë kapakun e vet?

z.Skender Hyseni: Përshëndetje, është shumë e nevojshme që të pastrohet shtrati i Lumit Shtimjanja sidomos në zonën e fshatrave të rrafshit sepse e kemi pa se çka ka ndodhur me vërshimet e mëdha, dhe që mund të ndodhin prapë, e që dëmet do të janë edhe më katastrofale, pytja është, kur do të pastrohet shtrati i lumit Shtimjanja? Pyetja e dytë ka të bëj me rrugët e arave. Rrugët bujqësore që janë shtruar me zhavorr, bujxit po presin vendosjen e disa gypave sepse ka nevojë që në disa vende të depërtoj uji që po grumbullohet gjatë të reshurave atmosferike, kush duhet që ti vendosë gypat, a i

vendos punëkryesi vetë apo duhet me i vendos Komuna, ne po kërkojmë në disa vende me u vendosë këta gypa me qëllim që të qarkullojë lirshëm uji atmosferik dhe mos të ketë përmbytje?

z.Shefki Dauti: Në mbledhjen e kaluar e kamë bërë pyetjen, pse nuk është rregulluar ujëmbledhësi (Reshetka) te rruga që shkon te shkolla e mesme përkatësisht te çerdhja e re, dhe kamë marrë një përgjigje, se “nuk e ka vlerësuar Kompania” ndërkaq që ne e kemi një kontratë me kompaninë “Ardhmëria” hiq më pak e as më shumë se 877.000€ e ajo punë i ka më shumë se dy muaj ditë, pse nuk po rregullohet ajo reshetkë? Po ashtu po e përsëris edhe një herë pyetjen te Rruga “Tranzit” nga Davidovci në drejtim të Lulishës “Agrokop” është prishë lidhja e bazës me urën dhe nëse aty hyn me shpejtësi sigurisht që i shkatron gomat e veturës, nuk e di në kompetenc te kujt bjen por edhe Komuna mundet me intervenuar se nuk është naj investim i madh, pse nuk po rregullohet? Pyetja e tretë është Ura në Rashinc, e pashë në përgjigje që është kontratë dy vjeçare, është e pa kuptimit tani ne tu themi fshatarëve kaloni kah të doni se ne e kemi një kontratë dy vjeçare, e dyta unë vërtetë nuk e di se kush e ka projektuar urën në fshatin Rashincë, 50 centimetra më poshtë se sa ura e vjetër dhe një prej shkaqeve është edhe kjo pse po ka vërvime në Rashincë, qka do të bëhet me këtë urë, dhe kur do të përfundojë rruga aty?

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje, pyetja ime nga mbledhja e kaluar ka qenë, pse nuk po mirëmbahet trotuari përgjat rrugës “Ibrahim Rugova” në fshatin Gjyrkovic, lagja te Hani, kur e kemi një operator të kontraktuar për mirëmbajtjen e trotuareve, e përgjigja nga drejtoria ishte se nuk kemi nga Kuvendi mjete të ndara për këtë projekt, ky projekt faktikisht është dhe kemi një kontratë për mirëmbajtje e nuk kemi të bëjmë me projekt te ri, unë po e përsëris prap këtë pyetje?

Te drejtoria e Inovacionit a është funksional, çfarë punë ka bërë dhe sa punëtor janë të punësuar aty në atë drejtori?

Pyetja e tretë e kemi përgjat rrugës Petrovë-Lalanisht, unë e kuptoj që ka vështërsi për lëvizje në atë rrugë sepse nuk kemi mirëmbajtje të duhur të asaj rruge, kur e dimë se në atë rrugë po shemben gurët nga kodra për qdo ditë, dhe po e rrezikojnë lëvizjen, shpesh herë kalimtarët zbresin prej veturave për me gjekë gurët nga rruga, pytja është farë masash ka marrë, drejtoria për mirëmbajtjen e kësaj rruge?

z.Besnik Seferi: Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Kurë duhet të përfundojë rruga në fshatin Rashincë? Pyetja e dyte, Shtimja ka bërë mjaft shumë për ndriçimin publik, por në disa vende nuk funksionon, sikurse është rasti në fshatin Reçak dhe në fshatin Petrovë, kur do të rregullohen këto defekte në ndriçimin publik? E treta, çështja e mbeturinave edhe përkundër pyetjeve të vazhdueshme prap po ndodhë në vazhdimësi, pyetja është sa është numri i Gjobave për ndotësit e ambientit në komunën e Shtimes?

z.Herolind Selmani: Përshëndetje, Për mbledhjen e radhës të Kuvendit, unë kërkoj nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, listën e Investimeve që janë bërë gjatë vitit 2020 dhe 2021 në ndriçimin publik, asfalltim dhe trotuar? Pyetja e dyte te Drejtoria për Zhvillim Ekonomik kërkoj listën e Bujqëve që kanë përfituar nga kjo drejtori për dëmet e shkaktuara nga reshjet atmosferike gjatë vitit të kaluar?

znj.Adelina Beqaj: Unë i përsëris pyetjet që i kam bërë nga mbledhja e kaluar sepse nuk kam marrë përgjigje: E para kur do të rregullohen (ulen) barrierat e vendosura në rrugën e Petrovës sepse janë shumë të larta, dhe po paraqesin pengesa, kjo ka qenë kërkesa ime në mbledhjen e kaluar? Ndërsa në pyetjen time nga mbledhja e kaluar se Kurë do të fillojë punën Çerdhja e re, nuk kamë marrë përgjigje nga asnjëra drejtori, prandaj po e përsëris pytjen?

Kryetari, z.Naim Ismajli: Unë dua të sqaroj se, meqenëse pati shumë vërejtje në kuptimin e kualitetit të dhënies së përgjigjeve, nga mbledhja e ardhshme, e Kuvendit të gjithë drejtorët do të jenë prezent në mbledhje dhe përgjigjet do ti merrni direkt aty për aty në mbledhje nga ta.

Pika 3

Raport i Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të komunës së Shtimes për vitin 2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Naim Ismajlit.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Faleminderit, unë nuk do të ju marr shumë kohë, sepse materialin e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar. Në dokument janë të prezantuara detaisht projektet dhe realizimi i tyre, ato projekte që kanë pas impakt në përmirësimin e jetës së qytetarit. Sa i përket Huamarrjes, përkohësisht është ndaluar puna, por tani po pritet që të vazhdojë puna në teren me përmirësimin e kushteve atmosferike, sepse furnizimi është bërë. Mund të them se kemi rrith 2,900,000€ investime të huaja, krahas këtijë viti të vështirë ekonomik për shkak të pandemisë Kovid19. Te zona Ekonomike dmth. Kemi pas edhe investime të huaja, dhe ka pas të punësuar rrith 200 punëtorë. (Shih dokumentin)

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për Informatën të cilën e kemi marrë me kohë, edhe pse nuk ishte mirë e formatizuar sepse kishte shumë gabime drejtshkrimore. Ne kemi disa vërejtje dhe pyetje. Fillimi isht duam sqarim të mirë për sa i përket Kolektorit për trajtimin e ujërave të zeza. Te Palestra Sportive janë investuar 60.000€ në qka konkretisht është investuar? Te Pishat është shtuar edhe aspekti sportiv, çka është shtuar konkretisht nga aspekti sportiv te Pishat përvetë aspektit rekreativ?

z.Ruzhdi Jashari; Edhe në KPF-ë ne i kemi ngritur disa çështje të prekshme dhe shqetësuese për qytetarët. Çështje shqetësuese është çështja e aktiviteteve të bizneseve, sepse pandemia ka pasë efekte negative te të gjithë banorët. Te pika 3 janë 193 ndryshime që dmth. Se bizneset janë detyruar me ndryshuar diqka. Te pika 7 kemi largim të bizneseve. Financimi nga huamarrja, Komuna e Shtimes me huamarrje ka hy në borgj dhe qytetarët duhet të paguajnë, Kryetari ka bërë fushatë të hatashme lidhur me këtë projekt, e tash është viti i tretë që nuk ka ende asgjë, e që është thënë se këtë vit është dashur të përfundohet. Paret janë shku e projekti ende nuk është askund. Pastaj objekti i arkivist, sa herë shkojmë te varrezat e shohim objetin e pa përfunduar. Për Kompleksin e Masakrës së Reçakut janë dhën rrith 100,000€ farë aktivitete janë bërë te ky kompleks, çka është punuar aty.

z.Sherifi Dauti; Faleminderit, për raportin. Gjendja financiare dhe ekonomike është stabile, marrë parasysh vështërsitë e pandemisë që kanë qenë në këtë periudhë. Më gjzon fakti që bizneset nga 600 është rritë në 800 prej tyre. Shtrimi i rrugëve të arave ka qenë projekt i qëlluar që e ka lehtësuar punën e bujqësive. Nuk është mirë që me i bërë qe tri herë pyetjet e njëta, sikurse disa kolegë. Në emër të grupit të PDK-së jemi që ky raport të kalojë.

z.Muhamed Ademaj; Unë desha të bëj një pyetje se a ka ndonjë plan për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore? Si dhe pyetja e dytë për Kryetarin, se a ka ndonjë plan për shtitjen e banesave të Komunës te ndërtesa e banimit kolektiv te Fitorja?

z.Rexhep Gashi; Nga ky raport mund të shihet se punët në teren nuk janë bërë të mirëfillta. Te sektori i bujqësisë, rastet që janë dëmtuar nga vërshimet, disa kanë marrë kompenzim e disa nuk po marrin. Sa i përket kriterieve, lind dyshimi se kriteret janë bërë duke ju përshtatur individëve të caktuar, psh. për aplikuesit e bletarëve, sepse është dashur të ketë numër të caktuar të bletëve.

z.Reshat Mujota; Përvendetje, te përfituesit e subvacioneve në sektorin e bujqësisë ka pasë kriter, dhe reporti ka qenë publik që unë e kam pa vetë. Unë e di saktësish se sa bujqë kanë fituar subvacione dhe që e kanë merituar. Unë po jap vetëm sqarim.

z.Rexhep Gashi; Ti Reshat nuk e kuptove pyetjen time. Vlerësimet duhet me i bërë drejtoria e jo me ja vendosur të drejtën dikujt paraprakisht.

z.Besnik Seferi; Në raport nuk është përfshi edhe mjetet e ndara për Kovid19. Unë po shpresoj që te Subvencionet të mos ndodhë ajo që ka ndodhë në nivelin qendror, me vjedhje. Pastaj në raport nuk ka një vlerësim për dëmet që u janë shkaktuar bizneseve gjatë pandemisë.

z.Reshat Mujota; Unë prap po sqaroj për Rexhën, ose ky nuk po don me kuptuar. Unë e di saktë se si ka shkuar kjo punë sepse edhe vetë jam përfitues.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Faleminderit për pyetjet. Klauzola Investive si emër të përgjithshëm e ka kanalizimin (Kolektorin) që ka ndodhur dhe që kemi folë për te disa herë. Është bërë blerja e

Tubacioneve si dhe puna që është duke u bërë në teren kapin vlerën rreth 1,600,000€. Këtë shumë e paguan Qeveria e Republikës së Kosovës, ndërsa Komuna nuk paguan asnjë cent, sepse kontraktues në këtë projekt është Qeveria e Republikës së Kosovës. Ne e përcjellim realizimin e projektit. Sa i përket investimeve te Palestra rreth 50,000€ kanë ndodhur në vitin 2020, si obligime që ka pas qeveria ndaj operatorit ekonomik, është e saktë që këto investime nuk janë të dukshme. Jashtë teritorit te pishat do të ketë edhe objekte sportive përveç rekreacionit. Objekti i Bibliotekës, investimet janë ndaluar nga niveli qendror, dhe ky ka qenë objekti që është sakrifikuar për shkak të pandemisë. Te Kompleksi i Reçakut është duke u punuar në disa rrugë. Ne mund të ju informojmë sakt nëse doni se përfar projekte po bëhet fjalë. Po e bëjmë Planin Zhvillimor, i kemi përfundu punët tona por ndërrimi i Qeverive shpesh paraqet edhe pengesat në ecjen e punëve. Ne po presim që Ministria e linjës të na jepin pëlgimin që Plani Komunal Zhvillimor është në përpunim me Planin Hapsinor të Kosovës. Ety pra në Planin Zhvillimor parashihet saktë mënyra e mbrojtjes së tokës bujqësore. Sa i përket banesave kjo është çështje e Kuvendit që do të vendos për to, mirëpo mund të them se në këtë drejtim nuk ka praktika të mira. Listat përfundimtare në komunën tonë nga vërvshimet janë dërguar në Qeveri, dhe ne po presim rezultatin e tyre. Ndarja e subvencioneve ka qenë transparente, sikurse që ka pas edhe kritere, ju inkurajoj që nëse ka paknaqësi ti adresojnë ato. Unë nuk kam pasë asnjë ankesë me shkrim në zyrën time për sa u përket ndarjes së Subvencioneve. **Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.**
*** Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 5 vota “Abstenim” aprovoi Raportin e Kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të komunës së Shtimes për vitin 2020.**

Pika 4

Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pasi lexoi Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj. Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Përshtendetje, materialin përfundimtare në formë të shkruar dhe e keni lexuar. Në vazhdim znj. Kimete Ukaj prezantoi pasqyrat financiare sipas tabelave duke lexuar shifrat sipas Kategorive Ekonomike. Unë i mirpres pyetjet ose sygjerimet e juaja, (shih dokumentin).

z.Nim Zejna; Unë edhe në KPF-ë i kamë bërë dy pyetje, ku kemi disa ndryshime te buxheti në paga, a janë përfshi në buxhet këto ndryshime dmth, a janë përfshi këto ndryshime në buxhet në raport me grantin Qeveritar? Dhe pyetja e dytë është se a ka ndihmuar në funksionalitet të organeve këto ndryshime?

z.Ruzhdi Jashari; Falemiderit për shpalosjen e pasqyrave financiare. Këto tregojnë ato që kanë ndodhur në realitet. Shqetësimet tona janë konkrete dhe të bazuara. Nëse e shohim psh. te shpenzimet Kontigjente nëpër Gjykata, aty ka shpenzime shumë më shumë se sanë vitin paraprak, kjo tregonë mjaftueshëm se këtu ka pas një performance të keqe. Ka arsyetime të shumta por nuk qëndrojnë, sepse mundësítë kanë qenë të bollshme përfundimtare me performuar më mire. Ku jemi të anëtaruar ne si Komunë, sepse nuk është e qartë te dokumentet zyrtare se kush, ku dhe qyshë.

z.Fehmi Hysenaj; Faleminderit për raportin nga ZKF-ja. Shumica e faqeve të dokumentit janë të çrrëgulluara. Shpenzimet kontigjente janë të larta. Po ashtu edhe shpenzimet prej 6,800€ përfundimtare, dhe Internet janë shumë të larta. Nuk do me thënë që nuk funksionon asgjë këtu, por ne si opozitë i shohim anët e dobëta.

z.Rexhep Gashi; Faleminderit për raportin. Është e qartë se ne këtu në Kuvend, vijmë nga sfera të ndryshme, prandaj po kërkoj disa sçarime. Te faqja 18 psh. furnizim me ushqim dhe piye 19,800€ nga operatori “Gryka” pyetja është kush ka hanger dhe kush ka pi aty? Te faqja 20, në dy vende kemi furnizim përfundimtare, me operatorë të ndryshëm pse? Te administrata kemi shpenzime shumë të

mëdha rreth 46,200€. Këtu paguhet keqmenaxhimi, kurë punëtorët detyrohen që të drejtat e tyre me i kërkuar nëpërmjet Gjykatave.

z.Muhamet Ademaj; Faleminderit për raportin. Pse nuk po paguhen arsimtarët për pagat jubilare, dhe për shujtat ushqimore, por po detyrohen me shkuar nëpër Gjykata?

z.Besnik Seferi; Faleminderit për raportin, e që ka mangësi të mëdha. Unë po kërkoj scharim për sa i përket punëtorëve që kanë qenë me kontrata, a janë në listat e pagave? Edhe e dyta te qiraja e tokave, për far toka po bëhet fjalë?

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; E para te pyetja e Naim Zejna, për ndryshimet e mundshme te pagat, përgjigjen e gjeni te faqja 4 e dokumentit, dhe në vazhdim lexoi të gjitha shifrat, duke e përfshirë edhe rezervën që e kini nda në Kuvend te tabela Nr.8 ku shihet qartë diferenca. Komuna jonë është e antarsuar në Asociacionin e Komunave të Kosovës e që duhet ta paguajmë rregullisht anëtarësimin tonë. Në dokument shkruan, “furnizim me ushqim dhe piye” (jo dreka zyrtare) ku përfshihen pakot ushqimore, psh. furnizimi te shtëpia e fëmijëve me nevoja të veqanta, etj. Te shpenzimet kontigjente, është një çështje që nuk kemi mjete të ndara për këtë destinim. Nuk kemi numër të punëtorëve jashtë listës së pagave. Në vazhdim sçaroj pyetjet e delegatëve sipas tabelave.

Kryetari, z.Naim Ismajli; Pasqyrat financiare shpalosen sipas standardeve që duhet tu përbahen të gjithë. Shpenzime kontigjente ka me pas edhe më shumë, sepse këtë gjendje e ka prodhuar Kontrata Kolektive. Kjo tash është barrë e komunave, dhe tash janë në trend administrata kommunale nga që ishin shëndetësia dhe arsimi. Shpenzimet reprezentative janë të caktuara me buxhet kjo është e çartë. Mjetet e ndara për pandemi në shumën prej 100,000€ i kemi marrë nga administrata, shëndetësia, arsimi, dhe këto të gjitha janë shpalosur në raport. Por ju mund të kërkoni specifikisht për secilin shpenzim në detaje.

z.Shefki Dauti; Asnjë prej neve tani nuk mund të themi se jemi pa përvojë. Këtu nuk ka asgjë të paqartë, vetëm nëse doni me i përsëritë të njëjtat gjëra disa herë. Për sa i përket pagave jubilare dhe shujtave unë mendoj se duhet të paguhen.

z.Rexhep Gashi; Unë kërkova sçarim te faqja 20 për përsëritjen dy herë të njejit shpenzim ku po bëhet fjalë për 46,200€ dhe nuk mora përgjigje. Pastaj nuk mora përgjigje edhe për furnizim me ushqim dhe piye 19,800€ nga operatori “Gryka”.

z.Besnik Seferi; Ne jemi të thirrur për ta trajtuar edhe këtë temë. Te faqja 20 ku po bëhet fjalë për furnizim me ushqim dhe piye, unë po pyes se a është shifra e njejtë sikurse në vitin e kaluar? Dhe tjetra pyetje për kend është bërë furnizimi me veshëmbathje?

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Secili furnizim që bëhet rexhistrohet në programin E-Pasuria, dhe aty mund ti gjeni të gjitha detajet. Sa i përket furnizim me veshëmbathje, Çerdhja e re është furnizuar me shtrojë e mbulojë e gjëra tjera.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 14 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 4 vota “Abstenim” aprovoi Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2020.**

Pika 5

Raport periodik për zbatimin e rekondimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Kimete Ukaj.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Për këtë pikë unë nuk do të ju marr shumë kohë, sepse materialin e keni marrë me kohë dhe jeni të njoftuar edhe më parë. Raportin unë do ta lexoj në pikat kryesore, sepse e kemi obligim ligjor që ta njoftojmë Kuvendin për ecurinë e zbatimit të rekondimeve të dhëna në raportin e auditimit nga zyra kombëtare e auditimit. Unë i mirëpres pyetjet e juaja.

z.Fehmi Hysenaj; Unë e di që këtë raport vetëm duhet me e sjellë dhe me e njoftuar Kuvendin, mirëpo nuk e di ku jeni bazuar se Kuvendi duhet me e aprovuar këtë raport, sepse reporti realisht është i zyrës kombëtare të auditimit, dhe ju vetem duhet implementuar rekomandimet e tyre.

z.Ruzhdì Jashari; Shqetësimet janë se këtë vit i kemi 10 rekomanime, e që aty përfshihen edhe rekomandimet për sa i përket Kontratës në vepër. Shqetësues është po ashtu edhe fakti se kemi rekomandime të auditorit që nga viti 2018 dhe 2019 e që nuk janë përmirësuar. Qytetarët i shohin të gjitha këto parregullsi. Në QKMF-ë kemi pas ushtrues detyre, është larguar ajo dhe tash aty e qojnë një kolegë këtu nga Kuvendi, prap si ushtruese të detyrës në QKMF-ë, kështu që fakte për parregullsi ka plot e përplot gjithandej. Pastaj shqetësues është edhe fakti se gati vit për vit përsëriten të njejtat rekomandime të auditorit.

znj.Kimete Ukaj, zyrtare kryesore financiare; Në raport unë e kamë cekë se e kamë obligim ligjor që ta dorëzoj në Kuvend. Se a diskutoni ju për këtë raport apo jo, ju e dini vetë.

Pika 6

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi Kërkesat e palëve, dhe rekomandimet e Komitetit për Politikë e Financa, si dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, kadastër dhe Gjeodezi si vijon:

1. z.Ekrem Shabani, nga fshati Godanc i Poshtëm, Kërkesa Nr.01-070/05-22250/20 datë: 04.10.2020, i cili ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës, që ti jepet në shfrytëzim 5-6 ari sipërfaqe në Ngastrën Kadasrtrale Nr.376-1, Zona Kadastrale- Godanc i Poshtëm, ku edhe është i vendosur objekti prej 62m² të cilin e ka ndërtuar vetë si bashkësi familjare, para lufte me lejen e organeve të atëhershme.

Në vazhdim Kryesuesja, Konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës me 15 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 2 vota “Abstenim” vendosi që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-22250/20, datë: 04.10.2020, e z.Ekrem Shabanit, nga fshati Godanc i Poshtëm të REFUZOHET.

2. z.Zymer Bajrami – nga fshati Rancë, Kërkesa Nr.01-070/05-25092/20 datë: 14.12.2020, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, një parcelë tokë (Truall) për ndërtimin e një Shtëpie banimi, meqenëse kam kontakt me donator për ndërtimin e një Shtëpie.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës me 10 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 6 vota “Abstenim” vendosi që kërkesa me numër: Nr.01-070/05-25092/20 datë: 14.12.2020, e z.Zymer Bajramit nga fshati Rancë të REFUZOHET.

3. zni.Arresha Syla - Godanc i epërm, anëtare e Kuvendit të Komunës-Shtime, Njoftim për dorëheqje Nr.01-070/05-4160/21 datë: 15.02.2021, Përmes kësaj shkrese, e njoftoj Kuvendin se ofroj dorëheqjen time nga funksioni i anëtares së Kuvendit të Komunës së Shtimes, nga radhët e PDK-së për arësy personale, angazhimin tim në një funksion tjetër publik.

4. zni.Zejnepe Hysenaj - Petrovë, Drejtoresh e Gjimnazit “Naim Frashëri” – Shtime, Njoftim Nr.01-070/05-4604/21 datë: 19.02.2021, Përmes kësaj shkrese, e njoftoj Kuvendin e Komunës së Shtimes se pas dorëheqjes të znj.Arresha Syla si anëtare e Kuvendit, sipas renditjes së votave unë jam në listën e kandidatëve femër që duhet të jem pjesë e Kuvendit me vota të dala nga zgjedhjet lokale 2017. Me këtë rast ju njoftoj se unë Zejnepe Hysenaj, nuk mund të jem pjesë e Kuvendit me arsyetimin se menjëher pas zgjedhjeve lokale 2017 i kamë ndërprerë të gjitha aktivitetet politike duke ju përkushtuar profesionit tim.

z.Fehmi Hysenaj; E falënderoj Arbreshën për punën dhe aktivitetin e sajë në këtë Kuvend, dhe i uroj punë të mabrë atje. Sa i përket Zejnepe Hysenaj, thënja e saj se ka pushuar aktivitetet e partisë për tju përkushtuar profesionit nuk qëndron sepse ka thirrë një nga një anëtarët në tubimin e partisë.

z.Muhamed Ademaj; E falënderoj Arbreshën dhe i uroj punë të mbarë.

z.Shekfi Dauti; Në emër të grupit parlamentar të PDK-së e falënderoj Arbreshën dhe i uroj punë të mbarë në QKMF-ë.

z.Besnik Seferi; I uroj suksese Arbreshës në punën e sajë, do të na mungoj shumë, në Kuvend pa të keq.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Në emër të Kuvendit, Arbreshën e falënderojmë për punën e sajë këtu në Kuvend, ndërsa i urojmë punë të mbarë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Shtime.

Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 12.⁴⁰h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi

Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

